



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 758 Prot.

Tiranë, më 16. 05. 2024

V E N D I M

Nr. 135, Datë 13. 05. 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.36 Regj., datë 11.03.2024, nga z.G. K., (në vijim ankuesi) kundër Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike dhe gjendjes shëndetësore.

K O N S T A T O N:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë në ankesë, pala ankuese pretendon se: *Unë jam G. K, i punësuar prej vitit 2020 në Ujësjellës Kanalizime Shkodër dhe gjatë këtyre viteve kam kaluar pozicione të ndryshme pune. Unë jam i diagnostikuar me hernie diskale që në vitin 2020 dhe për këtë arsye unë kam marrë disa raporte mjeksore në vitin 2023 konkretisht më datë 25.10.2023 - 08.11.2023, datë 08.11.2023-23.11.2023, datë 23.11.2023-08.12.2023, datë 08.12.2023- 23.12.2023 dhe në muajin dhjetor figuroj me kontribute deri më datën 11.01.2024 kur është lëshuar urdhëri largimit nga puna, pra nuk më janë paguar nga institucioni kontributet dhe pse unë kam qenë me raporte. Për faktin që unë rezultoj pa sigurime të derdhura dhe për këtë arsye nuk përfitoj asistencën si i papunë. Jam larguar direkt pa asnjë paralajmërim më datë 11.01.2024 dhe unë jam njoftuar më datë 20.01.2024, Në urdhërin e largimit është shkruar arsyeja e largimit është mosparaqitja në punë për shkaqe të pajustificuara gjatë muajit dhjetor 2023, kur unë kam qenë me raporte mjeksore. Nga ana tjetër diskriminimi fillon që në momentin kur nga Përgjegjës të Grupit të Taks Forcës, inspektor dhe faturues në Shkodër më dërgojnë në një pozicion më të vështirë pune me detyrë Operator Faturimi në Fushë Arrëz në tetor 2023, që për gjendjen time shëndetësore ky është një diskriminim pasi rruga për në Fushë Arrëz ndikon në keqsimin e*

shëndetit tim. Ky ndryshim erdhi si pasojë se pse në 01.09.2023, Ujësjetllës Kanalizime Shkodër u bë pjesë e strukturës së ujësjetllësve në rang Qarku. Me rikthimin në detyrë të ish drejtorit z. M. M., i cili u shkarkua më parë nga ish-Kryetari i Bashkisë Shkodër, z. B. S, (i forcës politike PD) dhe me ardhjen në pushtet të Partisë Socialiste me Kryetar Bashkia z. B. B, z. M. M, u rikthye në detyrë si drejtues tashmë i Shoqërisë Rajonale të Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a dhe si shenjë hakmarrje politike të gjithë punonjësit që kanë qenë në detyra dhe përkrahës të Partisë Demokratike dhe ish Kryetarit z. B. S, i ka ulur në pozicione deri dhe në largime nga puna. Unë dhe familja ime jemi anëtarë të Partisë Demokratike dhe aktivist të kësaj partie edhe kjo ka sjellë diskriminimin ndaj meje për shkaqe politike nga dërgimi në Fushë Arrëz deri në largimin nga puna.

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike, dhe gjendjes shëndetësore.

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën 31, datë 07.03.2024 bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën me nr. 428/1 prot., datë 20.03.2024, Komisioneri ka kërkuar informacion dhe dokumentacion në lidhje me çështjen nga Shoqërisë Rajonale e Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a, si subjekt kundër të cilit është paraqitur ankesa.

Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a, ka marrë dijeni për shkresën nr. 428/1 prot., datë 20.03.2024, më datën 25.03.2024, fakt ky që rezulton i provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar Nr. RR 5905 791 760 AA administruar në dosje, por nuk ka kthyer përgjigje.

- Me shkresën nr.428/2 prot., datë 22.04.2024, Komisioneri i është drejtuar sërish Shoqërisë Rajonale të Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a, me një kërkesë të përsëritur për informacion dhe dokumentacion në lidhje me çështjen.

Në shkresën e sipërpërmendur, Komisioneri i bën kujtesë subjektit, për të dërguar informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve, duke i sjellë në vëmendjen se

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

mosplotësimi i kësaj kërkesë, përbën shkelje të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a, ka marrë dijeni për shkresën nr. 428/2 prot., datë 22.04.2024, më datën 22.04.2024, fakt ky që rezulton i provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar me Nr. RR 594 059 672 AA, por nuk ka kthyer përgjigje.

III. Pas kryerjes së hapave të mësipërm proceduralë, Komisioneri çmon se:

Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a, si subjekt kundër të cilit është paraqitur ankesa nr.36, datë 11.03.2024 me palë ankuese z. G. K, me dijeninë e plotë nuk ka mbështetur Komisionerin në ushtrimin e kompetencës së tij ligjore për të shqyrtuar ankesat për diskriminim, të përcaktuar në nenin 32/1/a, të LMD-së duke mos dhënë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar.

Duke mos dhënë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 32/2, të LMD-së, sipas të cilit: *“2. Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij.”* Ky mosveprim, kjo mospërmbushje e këtij detyrimi ligjor, në bazë të nenit 33/13, të LMD-së shoqërohet me marrjen e masës administrative, gjobë.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi arrin në konkluzionin se, Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a, është në shkelje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 32/2, të LMD-së, shkelje e cila sipas nenit 33/13, të po këtij ligji, është e dënueshme me gjobë.

Për personat juridik, siç është në rastin konkret është Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a, neni 33, pika 13, të LMD-së, përcakton shprehimisht: *“Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë”*:..... *b) personi juridik nga 60.000 deri në 600.000 lekë;.....*”

Në lidhje me përcaktimin e masës së gjobës, Komisioneri mban në konsideratë parashikimet dhe kriteret e vendosura në nenin 33, pika 12, të LMD-së, ku sanksionohet se: *“12. Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës. Nëse vendoset gjobë, komisioneri përcakton shumën e gjobës duke marrë parasysh: i) natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi viktimën; dhe ii) rrethanat personale e financiare të shkelësit, veçanërisht duke marrë në konsideratë të gjitha burimet e të ardhurave dhe nëse shkelja kryhet nga një person juridik privat, merren parasysh aktivet e bilancit dhe fitimi, si dhe pagat totale të paguara punonjësve; c) nëse e njëjta shkelje diskriminon disa persona, vendoset vetëm një gjobë, por duke marrë parasysh kërkesat e shkronjës “b” të këtij neni.”*

Sa më sipër Komisioneri, arrin në përfundimin se, Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, duhet të gjobitet me 100 000 (njëqind mijë) lekë, për mosdhënien e informacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “ç” dhe pika 2, nenin 33, pikat 11, 12, 13 e 14, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, të gjobitet në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, për mosdhënien e informacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Gjoha të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda një muaji nga marrja dijani, mbi masën administrative. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 001, Distrikti (TDO) 3535, Llogaria ekonomike: 7115499.
3. Dërgimi i informacionit të kërkuar, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, sjell shfuqizimin e gjobës.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA